**SPECIFIKIME TEKNIKE**

***Per objektin :*** **“FV NDRICIM RRUGA "ASTI GOGOLI", L.14, SHKOZET"**

Ky investim ne kete segment do te kete ndertim te ri te rrjetit te ndricimit rrugor ne nje distance prej 800 ml per rrugen “Asti Gogoli” ,ndricimi do te behet pjeserisht ne te dy krahet e rruges.
Ne kete investim do te behet infrastruktura per 43 shtyllat dekorativ e ndricimit. Shtyll cilindrike çeliku i zinguar ne te nxehte dhe e lyer me boje elektyrostatike me shkalle mbrojtjeje IP 65, betonime per montimin e shtyllave dhe vendosjen e 44 pusetave elektrike ne nje trup te vetem.

Ndricimi ne kete investim do te kete dy funksione, edhe si pjese e arredimit ashtu dhe ane funksionale.

Ne kete rruge do te kemi 43 Shtylla ndricimi 7m .

**Gjendja Ekzistuese**









 

Linja kryesore e furnizimit te shtyllave do te jete 5 x 4 mm2 e future ne tubin fleksibel me dy shtersa d=80 mm ne nje kanal 40cm  te thell dhe percjellesin e tokezimit qe do te vendoset ne toke paralel me tubin. Ndersa cdo ndricues do te kete kabell cu 3x2.5 mm2.
Cdo shtylle do te kete puseten e tij me permasa 30 x30 x 30 . Puseta do te betonohet para shtylles. Bazamenti i instalimit te shtylles do te jete nje trup i vetem me puseten 30x30x30 dhe do te behet me beton te markes 200 ( shih detajin e montimit te shtylles).

Shtyllat do te tokezohen nepermjet percjellesve te tokezimit me  te cilet do te lidhen me elektrodat e tokezimit me gjatesi 1.5 m dhe te ngulura ne toke. Pecjellesi . tokezimit do te lidhet ne morseterine e jashtme te shtylles ne lartesine 10cm mbi nivelin e rruges. Ndersa percjellese qe do te siguroj vijueshmerine e rretit te tokezimit me  do te lidhet ne morseterine e trupit te shtylles qe ndodhet brenda zgavres se siperme. Lidhja e elementeve te tokezimit duhet te siguroje nje vijueshmiri pergjat gjithe linjes, ne menyre qe te siguroj nje mbrojtje me te mire nga kontaktet direkte. Bashke me shtyllen duhet treguar kujdes dhe me tokezimin e elementeve te tjere te shtylles si kapaku i morseterise dhe ndricuesi.Gjithashtu te tregohet kujdes me efektin e oksidimit, cdo pike lidhje te pastrohet me kujdes deri sa siperfaqa e kontaktit te mos kete papasterita.

Do te kemi 1 panel per komandimin e gjithe ndricimit.
Nga paneli 1 do te dalin dy linja ndricimi perkatesisht  L1,L2.L3  Sipas planimetrise pjese e projektit.

Linjat elektrike duhet te sinjalizohen per prezencen e tyre me an ate shiritave sinjalizuaes qe do te vendosen 20cm mbi nivelin e tubave.

**Mbrojtja e percjellesve nga rrymat e larta dhe rrymat e lidhjeve te shkurtra**

Te gjitha linjat elektrike per tu mbrojtur nga mbingarkesat do te mbrohen me automat te paisur me element magneto-termik.

**Kabllot e furnizimit me energji**

Kabllot dhe percjasat duhet te jene preje bakri dhe te izoluar me veshje PVC ose EPR me tension izolacioni minimum 450/750V simbas normave CEI 20-35 & CEI 20-22II te pershtatshem per instalime ne tuba.
Percjellsat dhe izolacionet e tyre duhet te jene ne gjendje te suportojne temperature 90°C ne rate normale dhe 250°C per kohe te shkurter ne raste avarie. Izolacioni kabllove duhet te jete i perbere nga materjale qe nuk ndimojne perhapjen e flakeve dhe gazeve toksik sipas CEI 20-35 & CEI 20-22 gjithashtu te kenaq dhe rezistencen ndaj goditjeve mekanike sipas CEI 20-11 e 20-34 te peshtatshem per instalime nen toke.

**Kuadri I komandimit**

Duhet te jete I realizuar conform normave dhe standarteve europiane EN 60529,EN50102 dhe EN 60950 me nje porte me llamarine inoksi me spesore materiali 5mm, tavani , dyshemeja dhe fletet anesore te kuadri te kene spesor 3mm i gjithe kuadri te jete i lyer me boje puder resistente ndaj temperaturave te larta dhe ngjyra te jete gri RAL 7035.
Kuadri do te jete i kompletuar me automatet mbrojtes ndaj mbingarkesave dhe lidhjeve te shkurtra. Relene fotometrike dhe te kete vend per pozicionimin e matjes qe do te vendoset nga ana e OSHEE.
Gjithashtu paneli i komandimit duhet te kete nje dritare qe te beje te mundur leximin e matjes.
Ne brendesi te paneleve do te instalohen paisjet mbrojtese si automatet, relet diferenciale, relet korpuskulare dhe kontaktoret.

Kuadri do te pozicionohet afer kabines se OSHEE

**Ndricuesit ne shtylla h 7ml. Te Tipit TP 1**


**Foto ilustruese**

Shtyll cilindrike dekorative 7m , çeliku i zinguar ne te nxehte dhe e lyer me boje elektrostatike me shkalle mbrojtjeje IP 65 + . Ndricuesi nga ana e rruges jo me te vogel se 100w,17000lm,4000-5000k, IP65..Me te gjithe aksesoret e montimit.

- **Para montim te ndricuesve duhet te shikohen nga supervizori dhe projektuesi.**

Ne perfundim te punimeve do te leshohet Deklarata e Instalimeve dhe protokolli i tokezimit nga Inxhinieri juaj elektrik i licensuar.